

Protestat studentore nuk kanë të bëjnë me marrëveshjen për arsimin!

Protestat paqësore, joviolente dhe studentore nuk do të ndalen deri në lirimin e pakusht të objekteve të okupuara universitare. – Partitë politike do t'i mbajmë anash...

– Çdo ditë e protestave do të ketë kreativitet. – Protestat tona nuk varen nga moda.

Eurozëri: Kur pritet të mbahen protestat e ardhshme?

A.Kurti: Protestat paqësore, joviolente dhe studentore, të filluara më 1 tetor 1997, nuk do të ndalen deri në realizimin e qëllimit të tyre: lirimin e pakusht të objekteve të okupuara universitare. Deri më datën 15 tetor 1997 do të presim konkretizimin e sugjerimeve dhe premtimeve të kontakt grupit. Pas kësaj do t'i informojmë studentët dhe opinionin në lidhje me datën e vazhdimit të protestave. Këtë e vendos Këshilli Organizativ për protesta në nivel të Universitetit të Prishtinës.

Eurozëri: A do të ndryshojë mënyra (forma) e mbajtjes së tyre. Nuk është e thënë të na tregoni si dhe çfarë do të jetë ajo mënyrë (formë) e mbajtjes së tyre.

A.Kurti: Mënyrat e protestimit do t'i bëhen me kohë të njohura studentëve dhe opinionit. Çdo ditë e protestimit do të ketë kreativitet, kurse format e këtij kreativiteti do të ndryshojnë nga dita në ditë.

Eurozëri: Si i vlerësol misionari amerikan, Robert Gelbard, protestat e 1 Tetorit, përkatësisht a mund të na thonë diç më tepër se sa që dihet nga ajo çka ka deklaruar deri sot ky misionar amerikan?

A.Kurti: Z. Gelbard e vlerësoi si shumë të suksesshme protestën e 1 Tetorit dhe shtoi se rruga e filluar e studentëve, që me protesta paqësore – studentore t'i arrijnë qëllimet e tyre, është rrugë plotësisht e pranueshme, rrugë që duhet përkrahur dhe mbështetur dhe, si e tillë, premtion shumë sukses.

Eurozëri: Si do të mund t'ia dilni që të mos i



lejoni të përzihen në "çështjen tuaj studentore" partitë e ndryshme politike dhe individualitetet e ndryshme, pasi që këtë e kanë diskutuar edhe Gelbard.

A.Kurti: Ideja e mospërzjerjes së partive politike rrjedh nga koncepti ynë, se ne si UPSUP jemi organizatë jopolitike, që, me protesta paqësore – studentore, dëshiron ta realizojë kthimin e objekteve dhe hapësirës universitare, qëllim ky, po ashtu, jopolitik. Më pastaj ky koncept ynë u mbështet edhe nga diplomatët e huaj, posaçërisht nga z. Gelbard. Partitë politike do t'i mbajmë anash, përmes kërkesave dhe apeleve eksplicite, me të cilat do t'iu drejtohem, por edhe përmes varianteve dhe formave të protestave.

Eurozëri: A mendoni se ka farë shansi minimal të realizohet marrëveshja Rugova-Milloseviq?

A.Kurti: Ajo që ju po e quani marrëveshje, është përplot paqartësi, që e bëjnë atë jo serioze dhe, si e tillë, s'ka si të realizohet.

Eurozëri: Po nëse realizohet, rastësisht, kjo "marrëveshje", a do të ndërpritet prote-

stat?

A.Kurti: Protestat paqësore – studentore nuk kanë të bëjnë me marrëveshjen. Ato ndalen vetëm kur të realizohet qëllimi i tyre: lirimin e pakusht të objekteve dhe hapësirës universitare.

Eurozëri: Kohë më parë keni përmendur katër fazat e protestave. Në cilën fazë jeni tani. A mund të na tregoni?

A.Kurti: UPSUP krijoi programin e vet të veprimit për organizimin e protestave, i cili ishte i ndarë në katër faza. Me datën 15 shtator 1997 u konstituua Këshilli Organizativ për protesta në nivel të Universitetit të Prishtinës. Ky këshill nxori edhe Platformën për protesta me datën 15 shtator 1997 dhe nga ajo datë veprohet në bazë të kësaj platforme të publikuar edhe për opinion.

Eurozëri: Si e vlerësoni pozicionin e subjekteve politike lidhur me protestat?

A.Kurti: Në fillim përkrahja, pastaj sugjerim për shtyrje dhe në fund, pas protestave përgëzimi dhe konstatimi i suksesit të tyre nga partitë politike ishin çështje e modës. Protestat tona nuk varen nga moda.

Eurozëri: A ka trezik të krijohen fraksione brenda Unionit të Pavarur të Studentëve sidomos pas përjashtimit të Albatros Rexhës?

A.Kurti: Jo, përkundrazi.

Eurozëri: Çfarë ishte pozicionimi i rektorit Statovci dhe kolegjiut të dekanëve lidhur me protestat. A dihen kush ka qenë pro e kush contra?

A.Kurti: Fjala pozicionim u korrespondoi më tepër atyre që mund t'i ndërrojnë pozicionet. Kjo fjalë nuk është adekuate për rektorin e UP-së, prof. dr. Ejup Statovcin. Ai përherë ka qenë i vendosur lidhur me protestat e studentëve. Suksesi i protestës nuk do të kishte këtë dimension pa kontributin e jashtëzakonshëm të rektorit të UP-së. Në mbledhjen e kolegjiut të dekanëve kishte për pos edhe disa kundër, apo më mirë të them për t'i shtyrë protestat. Dihet se cili dekanë ishin për shtyrjen e protestave dhe kjo ishte si rezultat se ata nuk kishin pavarësi intelektuale.

Bisedoi: KImete BERISHA